Universum International College
Powered by Arizona State University

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PRISHTINË - OPŠTINA PRIŠTINA
BIBLIOTEKA KOMUNALE - OPŠTINSKA BIBLIOTEKA
HIVZI SULEJMANI
Nr./Br. 22/06
Data/Datum 20.10.2026
PRISHTINË / PRIŠTINA

Biblioteka "HIVZI SULEJMANI" Prishtinë

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis

"UNI Universum International College", të cilën e përfaqëson, **Z. Alejtin Berisha**, si drejtor;

dhe

"Biblioteka Hivzi Sulejmani", të cilën e përfaqëson znj. Naime Beqiraj – Drejtoreshë e Bibliotekës "Hivzi Sylejmani ", Prishtinë

Të dyja palët nga këtu e tutje bashkërisht janë të referuara si "palët".

Neni 1 Qëllimi i marrëveshjes

2.1 Kjo marrëveshje bëhet me qëllim që **"UNI-Universum International College"** t'i dhurojë disa libra donacion në Bibliotekën "Hivzi Sulejmani'' në Komunën e Prishtinës si përkrahje e vazhdueshme në sistemin e arsimit në Komunën e Prishtinës duke e pasuruar edhe më shumë biblotekën e qytetit me tituj të ndryshëm të librave.

2.2 Përmes kësaj marreveshje sigurohet qasje e studentëve të **UNI – Universum International College '' të bëjnë shfrytëzimin e hapësirave për lexim dhe shfrytëzim të librave në Bibliotekën e Qytetit**".

Neni 2

Obligimet e "UNI Universum International College"

"UNI Universum International College" është i obliguar që të promovojë marrëveshjen dhe te dhurojë tituj të librave shkollore dhe akademik.

Universum International College
Powered by Arizona State University

Biblioteka
"HIVZI SULEJMANI"
- Prishtinë -

Neni 3

Kohëzgjatje e marrëveshjes

Kjo marrëveshje bëhet nga dt. **20.10.2026** deri në afat të pacaktuar. Kjo marrëveshje i referohet marrëveshjes së nënshkruar të dt. **25.04. 2024** .

Neni 4

Modifikimi/ Përfundimi

4.1 Cfarëdo ndryshimi/ plotësim i dispozitave të kësaj marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët e marrëveshjes. Ndryshimet/ plotësimet do të përcillen me një tekst të arsyeshmërisë për ndryshimin/ plotësimin që i dorëzohet secilës palë të marrëveshjes.
4.2 Marrëveshja konsiderohet e përfunduar me skadimin e afatit të përcaktuar për kohëzgjatje të saj, përpos nëse vazhdimi i marrëveshjes kontraktohet me pëlqim të shprehur me shkrim të të dyjave palët.

Hyrje në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga e palëve të kësaj marrëveshjes

Palët nënshkruese:

Biblioteka " Hivzi Sulejmani"

Datë: 20 / 10 /2026

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E PRISHTINËS · BIBLIOTEKA KOMUNALE · HIVZI SULEJMANI · PUBLIKA KOSTINA · PRISTINSKA BIBLIOTEKA

"UNI Universum International College"

Datë: 20 / 10 /2026